



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS SPANJOLLE



PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS

Sintaksë e gjuhës B

Ngarkesa: 4 krédite; 40 ore (20 leksione / 20 seminare)

Viti / Semestri : Viti II, semestri II

Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme

Programi i studimit: Bachelor ; dega: Gjuhë, Letërsi dhe Qytetërim hispanik

Kodi i etikës: Kodi i etikës i UT –së (nenet 4,6,7,9)

PËRMBLEDHJA DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Objektivat e përgjithshme lëndore: Ky kurs synon: Të zhvillojë aftësinë e të reflektuarit dhe të argumentuarit në fushën e sintaksës së gjuhës spanjolle. Është lëndë e detyrueshme, e cila ofrohet si formim bazik gjuhësor për studentët e gjuhës spanjolle në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja, Tiranë. Rekomandohet që studenti të zotërojë kompetencë komunikimi në gjuhën spanjolle dhe të zotërojë njohuri gramatikore mbi këtë gjuhë.

Objektivat specifike lëndore:

- 1.Të pajisë studentët që specializohen në fushën e gjuhësisë spanjolle, me nocionet themelore të sintaksës së gjuhës spanjolle dhe me tipologjinë kryesore të sistemit të saj.
- 2.Studenti duhet të arrijë të shpjegojë problemet që kanë të bëjnë me njësitë sintaksore themelore, si: fjalia e thjeshtë dhe gjymtyrët e saj kryesorë; problemi i fjalisë së përbërë; nocionet e sintagmave në gramatikën e gjuhës spanjolle, etj.
- 3.Studenti duhet të arrijë të përvetësojë dhe të zhvillojë aftësinë e të analizuarit dhe të komentuarit të teksteve dhe dokumentave të ndryshëm në fushën sintaksore të kësaj gjuhe.

Rezultatet të pritshme:

- 1.Të jenë në gjendje të zotërojnë njohuri bazë mbi kategoritë dhe funksionet sintaksore të gjuhës spanjolle, të përdorin saktë terminologjinë përkatëse gjuhësore dhe të realizojnë krahasime ndërgjuhësore.
2. Të aftësohen në komunikimin me gojë e me shkrim në spanjisht dhe do të punojnë në mënyrë të pavarur në analizën e strukturave sintaksore .